



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

---

V E N D I M

Nr.01, Datë 13.01.2020

PËR


**MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL PËR MENAXHIMIN E  
MBETJEVE TË NGURTA**

Në mbështetje të neneve 7, 10, 17 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, të VKM Nr. 881 datë 14.12.2016 “Për miratimin Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit”, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, të Vendimit Nr. 6 datë 17.05.2019 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e dokumentit të nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial për menaxhimin e mbetjeve të ngurta”, me propozimin e Ministrisë së Infrastrukturës së Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, (PKS MMN), pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
  - a) Strategjia Sektoriale shoqëruar me analizën sektoriale dhe territoriale, vizionin dhe objektivat strategjike të zhvillimit;
  - b) Plani i Zhvillimit të Sektorit, i cili përmban propozimet me përcaktime territoriale, planin e veprimeve dhe projektet e investimeve strategjike;
  - c) Rregullorja e Planit;
  - d) Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
  - e) Materiali Hartografik;

2. Gjatë hartimit të planeve të tjera sektoriale kombëtare, planeve të detajuara vendore për zona të rëndësishme kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta.
3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për kontrollin e përputhshmërisë së dokumentave të planifikimit, që hartohen nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit të territorit, me përcaktimet e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta.
4. Ngarkohen ministritë dhe institucionet e varësisë përgjegjëse për infrastrukturën, energjinë, turizmin, mjedisin, bujqësinë, agjencitë përgjegjëse për zbatimin e projekteve, të gjitha Këshillat e Qarqeve të Republikës së Shqipërisë, të gjitha bashkitë e Republikës së Shqipërisë si dhe çdo autoritet tjetër fusha e veprimtarisë së të cilit lidhet me territoret subjekt të këtij vendimi, për zbatimin e Planit Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve të Ngurta, si dhe bashkërendimin e punës me AKPT-së dhe ndërmjet tyre.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLEKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA FOTA

